

31998L0071

Direktiva 98/71 KE E PARLAMENTIT EUROPIAN DHE E KËSHILLIT datë 13 tetor 1998 për mbrojtjen ligjore të dizenjove industriale

Gazeta Zyrtare L 289, 28.10.1998, fq. 0028-0035

Direktiva 98/71 KE E PARLAMENTIT EUROPIAN DHE E KËSHILLIT datë 13 tetor 1998 për mbrojtjen ligjore të dizenjove industriale

PARLAMENTI EUROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Europian, dhe në veçanti nenin 100 a të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit (1),

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social (2)

Duke vepruar në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 189, shkronja b, të Traktatit, pika 3, duke pasur parasysh tekstin e përbashkët të miratuar nga Komiteti i Pajtimit më 29 qershor 1998,

(1) Meqë objektivat e Komunitetit, siç përcaktohen në Traktat, përfshijnë hedhjen e themeleve të bashkimit, gjithnjë e më të ngushtë ndërmjet popujve të Europës, nxitjen e marrëdhënieve të ngushta midis Shteteve Anëtare të Komunitetit, garantimin e përparimit ekonomik dhe social të vendeve të Komunitetit nëpërmjet veprimit të përbashkët për të eliminuar barrierat që ndajnë Europën; meqenëse për këtë qëllim Traktati parashikon krijimin e një tregu të brendshëm, të karakterizuar nga heqja e pengesave ndaj lëvizjes së lirë të mallrave, si dhe krijimin e një sistemi që garanton se konkurrenca në tregun e brendshëm nuk shtrembërohet; meqenëse përafrimi i ligjeve të Shteteve Anëtare për mbrojtjen ligjore të dizenjove do t'i shtyjë përpara ato objektiva;

(2) Meqë dallimet për mbrojtjen ligjore të dizenjove të ofruara nga legjislacioni i Shteteve Anëtare ndikojnë drejtpërdrejt në krijimin dhe funksionimin e tregut të brendshëm që lidhet me mallrat e dizenjove të materializuara; duke pasur parasysh se dallime të tilla mund ta shtrembërojnë konkurrencën brenda tregut të brendshëm;

(3) Meqë për funksionimin e mirë të tregut të brendshëm është i nevojshëm përafrimi i ligjeve të Shteteve Anëtare për mbrojtjen e dizenjove;

(4) Meqë për këtë, është e rëndësishme të merren në konsideratë zgjidhjet dhe përparësitë me të cilat sistemi i dizajnit të Komunitetit ofron marrëveshje që garantojnë të drejtat e dizajnit;

(5) Meqë është e panevojshme të ndërmerret në shkallë të gjerë përafrimi i ligjeve të Shteteve Anëtare për dizajnin, dhe është e mjaftueshme nëse përafrimi kufizohet në ato dispozita kombëtare të së drejtës që ndikojnë më drejtpërdrejt në funksionimin e tregut të brendshëm; meqë dispozitat mbi sanksionet, mjetet juridike dhe zbatimin duhet t'i lihen ligjit kombëtar; meqë objektivat e këtij përafrimi të kufizuar nuk mund të arrihen mjaftueshëm nga Shtetet Anëtare që veprojnë vetëm;

(6) Meqë Shtetet Anëtare duhet të mbeten të lira në përputhje me rrethanat për të rregulluar dispozitat procedurale lidhur me rinovimin, regjistrimin dhe pavlefshmërinë e të drejtave të dizenjës, dhe dispozitat në lidhje me efektet e kësaj pavlefshmërie;

(7) Meqë kjo direktivë nuk përjashton për dizenjot zbatimin e legjislationit kombëtar apo komunitar që garanton mbrojtjen, përveçse kur dizajni jepet nëpërmjet regjistrimit apo publikimit, si legjislationi që lidhet me të drejtat e dizajnit të përgjithshëm, markat tregtare, patentat dhe modelet e përdorimit, konkurrenca e pandershme apo përgjegjësitë civile;

(8) Meqë në mungesë të harmonizimit të së drejtës së autorit është e rëndësishme të vendoset parimi i kumulimit të mbrojtjes sipas ligjit të veçantë për mbrojtjen e dizenjës së regjistruar, dhe ligjit të së drejtës së autorit, duke i lënë Shtetet Anëtare të lira për të përcaktuar shkallën e mbrojtjes të së drejtave të autorit dhe kushtet nën të cilat kjo mbrojtje jepet;

(9) Meqë arritja e objektivave të tregut të brendshëm kërkon që kushtet për marrjen e së drejtës për regjistrimin e dizajnit të jenë të njëjta në të gjitha Shtetet Anëtare; meqë për këtë qëllim është e nevojshme të jepet një përkufizim unik i nocionit të dizajnit dhe të kërkesave si për risinë dhe karakterin individual me të cilat duhet të përputhen të drejtat e regjistrimit të dizajnit;

(10) Meqë është e nevojshme, në mënyrë që të lehtësohet lëvizja e lirë e mallrave, të sigurohet në parim se të drejtat e regjistrimit të dizajnit i japin zotëruesit të së drejtës mbrojtje ekuivalente në të gjitha Shtetet Anëtare;

(11) Meqë mbrojtja për zotëruesin e së drejtës jepet nëpërmjet regjistrimit të karakteristikave të dizajnit të një produkti, në tërësi ose pjesërisht, të cilat paraqiten dukshëm në aplikim dhe vihen në dispozicion të publikut me anë të publikimit apo konsultimit të dosjes përkatëse;

(12) Meqë mbrojtja nuk duhet të shtrihet në ato pjesë përbërëse të cilat nuk janë të dukshme gjatë përdorimit normal të produktit, ose në atë pjesë karakteristikat e së cilës nuk janë të dukshme kur pjesa montohet, ose që nuk përmbushin, në vetvete, kërkesat për risinë dhe karakterin individual; meqë karakteristikat e dizajnit të cilat përjashtohen nga mbrojtja për këto arsye nuk duhet të merren parasysh për qëllime vlerësimi nëse karakteristika të tjera të dizajnit përmbushin kërkesat për mbrojtje;

(13) Meqë vlerësimi duhet të bazohet në atë nëse përshtypja e përgjithshme që i jepet një përdoruesi të informuar, duke shikuar dizajnin, ndryshon dallueshëm nga ajo që i jepet atij nga

korpusi ekzistues i dizajnit, duke marrë parasysh natyrën e produktit në të cilën dizajni aplikohet ose në të cilën është përfshirë, dhe në veçanti sektorin industrial të cilit i përket dhe shkallën e lirisë së projektuesit për zhvillimin e dizajnit;

(14) Meqë risia teknologjike nuk duhet të pengohet duke i dhënë mbrojtje dizajnit vetëm për karakteristika të diktuar për funksion teknik; meqë kuptohet se kjo nuk detyron që dizajni duhet të ketë një cilësi estetike; meqë, gjithashtu, ndërfunksionimi i produkteve të markave të ndryshme nuk duhet të pengohet duke zgjeruar mbrojtjen për dizajno të pajisjeve mekanike; meqë tiparet e një dizajni të cilat përjashtohen nga mbrojtja për këto arsye nuk duhet të merren parasysh për qëllime vlerësimi, nëse karakteristikat e tjera të dizajnit përmbushin kërkesat për mbrojtje;

(15) Meqë pajisjet mekanike të produkteve modulare ose rregulluese mund, megjithatë, të përbëjnë një element të rëndësishëm të karakteristikave të reja të produkteve modulare dhe të paraqesin vlerë të madhe marketingu dhe, për këtë arsye, duhet të jenë të pranueshme për mbrojtjen;

(16) Meqë një e drejtë dizajni nuk ekziston në një dizajn i cili është në kundërshtim me politikën publike ose parimet e pranuar morale; meqë kjo direktivë nuk përbën harmonizim të koncepteve kombëtare të politikës publike ose parimeve të pranuar morale;

(17) Meqë është thelbësore për funksionimin e mirë të tregut të brendshëm të unifikohet termi i mbrojtjes që jepet nga të drejtat e regjistrimit të dizajnit;

(18) Meqë dispozitat e kësaj direktive nuk cenojnë zbatimin e rregullave të konkurrencës sipas neneve 85 dhe 86 të Traktatit;

(19) Meqë miratimi i shpejtë i kësaj direktive është bërë çështje urgjence për një numër sektorësh industrialë; meqë përafrimi në shkallë të plotë i ligjeve të Shteteve Anëtare për përdorimin e dizenjove të mbrojtura me qëllim që të lejohet riparimi i një produkti kompleks aq sa të rikthehet pamja e tij origjinale, ku produkti që përfshin dizajnin ose në të cilin dizajni zbatohet, përbën elementin përbërës të një produkti kompleks sipas pamjes së të cilit dizajni i mbrojtur është i varur, nuk mund të paraqitet në fazën aktuale; meqë mungesa e përafrimit në shkallë të plotë të ligjeve të Shteteve Anëtare për përdorimin e dizenjove të mbrojtura për riparim të një produkti kompleks nuk duhet të përbëjë pengesë për përafrimin e dispozitave të tjera kombëtare të ligjit të dizajnit, që ndikon më drejtpërdrejt në funksionimin e tregut të brendshëm; meqë për këtë arsye, Shtetet Anëtare ndërkohë duhet të mbajnë në fuqi, në përputhje me Traktatin, çdo dispozitë që lidhet me përdorimin e dizajnit të një pjesë përbërëse të përdorur për qëllime të riparimit të një produkti kompleks, në mënyrë që të rikthehet pamja e tij origjinale, ose, nëse ato paraqesin ndonjë dispozitë të re që ka lidhje me një përdorim të tillë, qëllimi i këtyre dispozitave duhet të jetë vetëm liberalizimi i tregut të këtyre pjesëve; meqë ato Shtete Anëtare të cilat, në datën e hyrjes në fuqi të kësaj direktive, nuk garantojnë mbrojtje për dizajnot e pjesëve përbërëse nuk u kërkohet të paraqesin regjistrimin e dizajnit për këto pjesë; meqë tre vjet pas datës së zbatimit Komisioni duhet të paraqesë një analizë të efekteve të dispozitave të kësaj direktive për

industrinë e Komunitetit, për konsumatorët, për konkurrencën dhe për funksionimin e tregut të brendshëm; meqë, në lidhje me pjesët përbërëse të produkteve komplekse, analiza duhet, në veçanti, të marrë në konsideratë harmonizimin në bazë të opsioneve të mundshme, përfshi një sistem të shpërblimit dhe një afat të kufizuar të ekskluzivitetit; meqë, jo më vonë se një vit pas paraqitjes së analizës së tij, Komisioni duhet, pas konsultimit me palët më të prekura, t'i propozojë Parlamentit European dhe Këshillit ndonjë ndryshim për këtë direktivë që nevojitet për të plotësuar tregun e brendshëm në lidhje me pjesët përbërëse të produkteve komplekse, dhe çdo ndryshim tjetër që e konsideron të nevojshëm;

(20) Meqë dispozita kalimtare në nenin 14 në lidhje me dizajnin e një pjese përbërëse të përdorur për qëllime të riparimit të një produkti kompleks, në mënyrë që të rikthehet pamja e tij origjinale, nuk duhet në asnjë rast të interpretohet se përbën ndonjë pengesë për lëvizjen e lirë të një produkti i cili formon një pjesë të tillë përbërëse;

(21) Meqë arsyet thelbësore për refuzimin e regjistrimit në ato Shtete Anëtare të cilat ofrojnë materiale për ekzaminimin e aplikacioneve para regjistrimit, si dhe arsyet thelbësore për pavlefshmërinë e të drejtave të regjistrimit të dizajnit në të gjitha Shtetet Anëtare duhet të renditen plotësisht;

KANË MIRATUAR KËTË DIREKTIVË

Neni 1

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj direktive:

(a) “dizajn” do të thotë pamje e tërë ose e një pjese e produktit që rrjedh nga karakteristikat, në veçanti e linjave, kontureve, ngjyrave, formës, strukturës dhe / ose materialeve të vetë produktit dhe / ose zbukurimet e tij ;

(b) “produkt” nënkupton çdo send industrial ose artizanal, përfshi ndër të tjera pjesë të caktuara që bashkohen ose montohen në një produkt kompleks, paketim, karakteristika të pamjes vizuale, simbole grafike dhe pamje tipografike, por duke përjashtuar programet kompjuterike;

(c) “Produkt kompleks” do të thotë një produkt i cili përbëhet nga komponentë të shumtë të cilët mund të zëvendësohen duke lejuar zërthimin dhe ribashkimin e produktit.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Kjo direktivë zbatohet për:

(a) të drejtat e regjistrimit të dizajnit në zyrat qendrore të pronësisë industriale të Shteteve Anëtare;

(b) të drejtat e dizajnit të regjistruar në Zyrën e Dizajnit Beneluks;

(c) të drejtat e dizajnit të regjistruar sipas marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat kanë efekt në një Shtet Anëtar;

(d) kërkesat për të drejtat e dizajnit të përmendura nën shkronjat (a), (b) dhe (c).

2. Për qëllim të kësaj direktive, regjistrimi i dizajnit përfshin edhe publikimin pas paraqitjes së dizajnit nga zyra e pronësisë industriale e një Shteti Anëtar në të cilën një publikim i tillë mundëson ekzistencën e një dizajni të drejtë.

Neni 3

Kërkesat e mbrojtjes

1. Shtetet Anëtare i mbrojnë dizajnët me anë të regjistrimit, dhe u japin të drejta ekskluzive zotëruesve të tyre në përputhje me dispozitat e kësaj direktive.

2. Një dizajn mbrohet nga e drejta e dizajnit deri në masën që është i ri dhe ka karakter individual;

3. Një dizajn i aplikuar ose i përfshirë në një produkt i cili formon pjesën përbërëse të një produkti kompleks merret në konsideratë vetëm po të jetë i ri dhe të ketë karakter individual;

(a) nëse pjesa përbërëse, pasi të jetë përfshirë në produktin kompleks, mbetet e dukshme gjatë përdorimit normal të këtij të dytit, dhe

(b) deri në atë masë që këto karakteristika të dukshme të pjesës përbërëse përmbushin në vetvete kërkesat si në risi dhe me karakterin individual;

4. “Përdorimi normal” brenda kuptimit të paragrafit 3, shkronja (a) do të thotë përdorim nga ana e përdoruesit të fundit, duke përjashtuar mirëmbajtjen, servisin ose riparimin.

Neni 4

Risia

Një dizajn konsiderohet i ri nëse nuk është vënë ndonjë dizajn identik në dispozicion të publikut para datës së paraqitjes së kërkesës për regjistrim ose, nëse pretendohet për prioritet, data e prioritetit. Dizenjot konsiderohen të jenë identike nëse karakteristikat e tyre ndryshojnë vetëm në hollësi jomateriale.

Neni 5

Karakterit individual

1. Një dizajn konsiderohet të ketë karakter individual, nëse përshtypja e përgjithshme që i jepet përdoruesit të informuar ndryshon nga përshtypja e përgjithshme që i jepet këtij përdoruesi nga ndonjë dizajn i cili vihet në dispozicion të publikut para datës së dorëzimit të aplikimit për regjistrim ose, nëse pretendohet për prioritet, data e prioritetit.
2. Në vlerësimin e karakterit individual merret në konsideratë shkalla e lirisë së projektuesit për zhvillimin e dizajnit.

Neni 6

Zbulimi

1. Me qëllim zbatimin e neneve 4 dhe 5, një dizajn mendohet të jetë i disponueshëm për publikun nëse është publikuar pas regjistrimit, ose ndryshe, është ekspozuar, përdorur në tregti ose është zbuluar, përveç kur këto raste nuk mund të jenë bërë të njohura në rrjedhën normale të biznesit tek rrethet e specializuara në sektorin përkatës, që veprojnë në kuadër të Komunitetit, para datës së paraqitjes së kërkesës për regjistrim ose, nëse pretendohet për prioritet, data e prioritetit.

Megjithatë, dizajni nuk mendohet të jetë bërë i disponueshëm për publikun për të vetmen arsye se i është zbuluar një personi të tretë në kushte sinqeriteti ose të nënkuptuara të konfidencialitetit.

2. Një zbulim nuk merret në konsideratë për qëllim të zbatimit të neneve 4 dhe 5 nëse një dizajn, për të cilën kërkohet mbrojtja sipas të drejtës së dizajnit të regjistruar të një Shteti Anëtar, është vënë në dispozicion të publikut:

(a) nga ana e projektuesit, pasardhësit të tij në titull, apo një personi të tretë si rezultat i informacionit të dhënë ose veprimit të ndërmarrë nga ana e projektuesit, ose pasardhësit të tij në titull, dhe

(b) gjatë periudhës 12-mujore para datës së depozitimit të aplikimit ose, nëse pretendohet për prioritet, data e prioritetit.

3. Paragrafi 2 zbatohet edhe nëse dizajni është vënë në dispozicion të publikut si pasojë e një abuzimi në lidhje me projektuesin ose pasardhësin e tij në titull.

Neni 7

Dizajnë të diktuar nga funksioni i tyre teknik dhe dizajn interkonjeksioni (që ndërlihen)

1. Një e drejtë dizajni nuk vazhdon të ekzistojë në veçoritë e pamjes së jashtme të një produkti të cilat diktohen vetëm nga funksioni i tij teknik.
2. Një e drejtë dizajni nuk vazhdon të ekzistojë në veçoritë e pamjes së jashtme të një produkti i cili duhet detyrimisht të riprodhohet në formën dhe dimensionet e tij të sakta, për të lejuar produktin në të cilin dizajni është inkorporuar ose është aplikuar të lidhet ose të vendoset mekanikisht, prapa ose përballë një produkti tjetër, kështu që secili produkt të mund të kryejë funksionin e tij.
3. Pa kundërshtuar paragrafin 2, një e drejtë dizajni, sipas kushteve të përcaktuara në nenet 4 dhe 5, vazhdon të ekzistojë në një dizajn që shërben për të lejuar bashkimin e shumëfishtë ose lidhjen e produkteve reciprokisht të këmbyeshëm brenda një sistemi modular.

Neni 8

Dizajnë në kundërshtim me politikat publike ose moralin

Një e drejtë dizajni nuk ekziston në një dizajn i cili është në kundërshtim me politikat publike ose parimet e pranuar morale.

Neni 9

Fusha e mbrojtjes

1. Fusha e mbrojtjes që jepet nga një e drejtë dizajni duhet të përfshijë çdo dizajn që nuk shkakton tek përdoruesi i informuar një përshtypje të ndryshme në përgjithësi.
2. Në vlerësimin e fushës së mbrojtjes, merret në konsideratë shkalla e lirisë së projektuesit në zhvillimin e dizajnit të tij.

Neni 10

Kohëzgjatja e mbrojtjes

Siç përcaktohet nga regjistrimi, një dizajn i cili përmbush kërkesat e nenit 3, pika 2, mbrohet nga një e drejtë dizajni për një ose më shumë periudha prej pesë vjetësh nga data e paraqitjes së kërkesës. Zotëruesit të së drejtës mund t'i përtërihet afati i mbrojtjes për një ose më shumë periudha prej pesë vjetësh, deri në një afat të përgjithshëm prej 25 vjetësh nga data e depozitimit.

Neni 11

Pavlefshmëria ose refuzimi i regjistrimit

1. Një dizajn i refuzohet regjistrimi, ose, nëse dizajni është regjistruar, e drejta e dizajnit shpallet e pavlefshme:

(a) nëse dizajni nuk është dizajn në kuptim të nenit 1, shkronja (a); ose

(b) nëse ai nuk përmbush kërkesat e neneve 3 deri 8; ose

(c) në qoftë se aplikantit ose zotëruesit të së drejtës së dizajnit nuk i është dhënë e drejta për të sipas ligjit të Shtetit Anëtar në fjalë; ose

(d) nëse dizajni bie ndesh me një dizajn të mëparshëm që është vënë në dispozicion për publikun pas datës së depozitimit të aplikimit ose, nëse pretendohet për prioritet, data e prioritetit, dhe e cila mbrohet nga një datë përpara datës së lartpërmendur nga një dizajn i regjistruar i Komunitetit ose nga një aplikim për një dizajn të Komunitetit i regjistruar, ose nga një e drejtë dizajni e Shtetit Anëtar përkatës, ose nga një kërkesë për një të drejtë të tillë.

2. Çdo Shtet Anëtar mund të garantojë që një dizajn i t'i refuzohet regjistrimi, ose, nëse dizajni është i regjistruar, atëherë e drejta e dizajnit shpallet e pavlefshme:

(a) nëse një shenjë dalluese përdoret në një dizajn pasues, dhe ligji i Komunitetit ose ligji i Shtetit Anëtar përkatës që rregullon këtë shenjë i jep zotëruesit të së drejtës së shenjës të drejtën të ndalojë këtë përdorim; ose

(b) nëse dizajni përbën një përdorim të paautorizuar të një veprë të mbrojtur sipas ligjit të autorit të Shtetit Anëtar në fjalë, ose

(c) nëse dizajni përbën një përdorim të gabuar të ndonjë prej pikave të renditura në nenin 6, shkronja (b) të Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale, ose të shenjave, emblemave dhe pllakave metalike përveç atyre që përfshihen nga neni 6, shkronja (b) të Konventës së lartpërmendur, të cilat kanë interes të veçantë publik në Shtetin Anëtar në fjalë.

3. Arsyetja e dhënë në paragrafin 1, shkronja (c) mund të kërkohet vetëm nga personi që ka të drejtën e dizajnit sipas ligjit të Shtetit Anëtar në fjalë.
4. Arsyet e dhëna në paragrafin 1, shkronja (d) dhe në paragrafin 2, shkronjat (a) dhe (b) mund të kërkohen vetëm nga aplikanti ose zotëruesi i së drejtës konfliktuale.
5. Arsyetja e dhënë në paragrafin 2, shkronja (c) mund të kërkohet vetëm nga personi ose subjekti në fjalë sipas përdorimit.
6. Paragrafët 4 dhe 5 nuk cenojnë lirinë e Shteteve Anëtare për të garantuar se arsyet e parashikuara në paragrafin 1, shkronja (d) dhe paragrafin 2, shkronja (c) mund të kërkohen gjithashtu nga autoriteti përkatës i Shtetit Anëtar në fjalë me iniciativën e vet.
7. Kur një dizajni i është refuzuar regjistrimi apo një e drejtë dizajni është shpallur e pavlefshme sipas paragrafit 1, shkronja (b) ose paragrafit 2, dizajni mund të regjistrohet ose e drejta e dizajnit mbahet në një formë të ndryshuar, nëse në atë formë ajo përputhet me kërkesat për mbrojtjen dhe ruhet identiteti i dizajnit. Regjistrimi ose mbajtja në një formë të ndryshuar mund të përfshijë regjistrimin të shoqëruar me një mohim të pjesshëm nga ana e zotëruesit të së drejtës së dizajnit ose futjes në Regjistrin e dizajnit të një vendimi të gjykatës që deklaron pavlefshmërinë e pjesshme të së drejtës së dizajnit.
8. Çdo Shtet Anëtar mund të parashikojë që, me derogim nga paragrafët 1 deri në 7, arsyet për refuzimin e regjistrimit ose për pavlefshmërinë në fuqi në atë shtet përpara datës në të cilën dispozitat e nevojshme në përputhje me këtë direktivë hyjnë në fuqi zbatohen për aplikacionet e dizajnit të cilat janë bërë para kësaj date dhe për regjistrimet që rezultojnë.
9. Një e drejtë dizajni mund të shpallet e pavlefshme edhe pasi ajo ka skaduar ose është dorëzuar.

Neni 12

Të drejtat që rrjedhin nga e drejta e dizajnit

1. Regjistrimi i një dizajni i jep zotëruesit të drejtën ekskluzive për ta përdorur atë dhe për të parandaluar ndonjë palë të tretë që nuk ka pëlqimin e tij për ta përdorur atë. Përdorimi i sipërpërmendur mbulon, në veçanti, krijimin, paraqitjen, hedhjen në treg, importimin, eksportimin ose përdorimin e një produkti në të cilin dizajni është inkorporuar ose në të cilin është aplikuar, ose magazinimin e një produkti të tillë për ato qëllime.
2. Kur, sipas ligjit të një Shteti Anëtar, aktet e referuara në paragrafin 1 nuk mund të parandalohen para datës që dispozitat e nevojshme në përputhje me këtë direktivë hyjnë në fuqi, të drejtat që rrjedhin nga e drejta e dizajnit mund të mos kërkohen për të parandaluar vazhdimin e këtyre akteve nga ndonjë person i cili i kishte filluar këto akte para kësaj date.

Neni 13

Kufizimi i të drejtave që rrjedh nga e drejta e dizenjove industriale

1. Të drejtat që rrjedhin nga një e drejtë mbi regjistrimin e dizenjove industriale nuk ushtrohen në lidhje me:
 - (a) veprime të kryera privatisht dhe për qëllime jokomerciale;
 - (b) veprime të kryera për qëllime eksperimentale;
 - (c) akte të riprodhimit për qëllime të citimit ose të mësimdhënies, me kusht që akte të tilla të jenë në përputhje me praktikën e tregtisë së ndershme dhe të mos paragjykohet padrejtësisht shfrytëzimi normal i dizenjot, dhe që referimi të bëhet nga burimi.

2. Përveç kësaj, të drejtat e dhëna nga një e drejtë mbi regjistrimin e dizenjove industriale nuk ushtrohen në lidhje me:
 - (a) pajisjet për anijet dhe avionët të regjistruar në një vend tjetër, kur këto hyjnë përkohësisht në territorin e Shtetit Anëtar në fjalë;
 - (b) importimin e pajisjeve dhe pjesëve rezervë me qëllim riparimin e anijeve dhe avionëve;
 - (c) ekzekutimin e riparimeve për mjete të tilla.

Neni 14

Dispozitë kalimtare

Megjantëse deri në këtë kohë ndryshimet në këtë direktivë janë miratuar me propozim të Komisionit, në përputhje me dispozitat e nenit 18, Shtetet Anëtare i mbajnë në fuqi dispozitat e tyre ekzistuese ligjore që kanë të bëjnë me përdorimin e një pjese përbërëse të dizajnit të përdorur për qëllimet e riparimit të një produkti kompleks, në mënyrë që të rikthehet pamja e tij origjinale, dhe paraqesin ndryshime për ato dispozita, vetëm, nëse qëllimi është që të liberalizohet tregu për pjesë të tilla.

Neni 15

Ezaurimi i të drejtave

Të drejtat e dhëna nga një e drejtë e regjistrimit të dizajnit nuk shtrihen në akte që lidhen me një produkt në të cilin dizajni i përfshirë brenda fushës së mbrojtjes inkorporohet, ose në të cilën aplikohet, kur produkti nxirret në treg në Komunitet nga zotëruesi i së drejtës së dizajnit ose me pëlqimin e tij.

Neni 16

Marrëdhënia me format e tjera të mbrojtjes

Dispozitat e kësaj direktive nuk cenojnë ndonjë dispozitë të ligjit të Komunitetit ose të ligjit të Shtetit Anëtar në fjalë, në lidhje me të drejtat e dizajnit të përgjithshëm, markat tregtare ose shenja të tjera dalluese, patentat dhe modelet e përdorimit, karakteristikat e pamjes vizuale, të përgjegjësive civile ose konkurrencës së pandershme.

Neni 17

Marrëdhënia me të drejtën e autorit

Një dizajn i mbrojtur nga një e drejtë dizajni regjistruar në përputhje me këtë direktivë për, ose për sa i përket, një Shteti Anëtar i lejohet gjithashtu mbrojtja sipas ligjit të autorit të atij shteti, që nga data në të cilën dizajni është krijuar ose fiksuar në çdo lloj forme. Masa në të cilën, si dhe kushtet nën të cilat, një mbrojtje e tillë jepet, përfshi nivelin e origjinalitetit të kërkuar, përcaktohet nga secili Shtet Anëtar.

Neni 18

Rishikimi

Tre vjet pas datës së zbatimit të përcaktuar në nenin 19, Komisioni paraqet një analizë të efekteve të dispozitave të kësaj direktive për industrinë e Komunitetit, në veçanti për sektorët industrialë që preken më shumë, sidomos prodhuesit e produkteve komplekse dhe pjesëve përbërëse, për konsumatorët, për konkurrencën dhe për funksionimin e tregut të brendshëm.

Jo më vonë se pas një viti, Komisioni i propozon Parlamentit Europian dhe Këshillit ndonjë ndryshim për këtë direktivë, që nevojitet për të plotësuar tregun e brendshëm, në lidhje me pjesët përbërëse të produkteve komplekse, si dhe çdo ndryshim tjetër që ai konsideron të domosdoshëm në kuadrin e konsultimeve me palët më të prekura.

Neni 19

Zbatimi

1. Shtetet Anëtare sjellin në fuqi ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative të nevojshme për t'u përputhur me këtë direktivë, jo më vonë se 28 tetor 2001. Kur Shtetet Anëtare miratojnë këto dispozita, ata përfshijnë një referencë për këtë direktivë ose shoqërohet nga kjo referencë me rastin e botimit të tyre zyrtar. Metodot e bërjes së një reference të tillë përcaktohen nga Shtetet Anëtare.

2. Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit dispozitat e ligjit kombëtar që ata miratojnë në fushën e mbuluar nga kjo direktivë.

Neni 20

Hyrja në fuqi

Kjo direktivë hyn në fuqi njëzet ditë pas botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane.

Neni 21

Adresuesit

Kjo direktivë i drejtohet Shteteve Anëtare.

Nënshkruar në Luksemburg, më 13 tetor 1998.

Për Parlamentin Europian

Presidenti

J. M. GIL-ROBLES

Për Këshillin

Presidenti

C. EINEM